



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 20 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

**Urdhër për Riklasifikimin e Raportit të Parë të Zyrës Administrative mbi Kërkesat
e Viktimave për Pjesëmarrje**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës

Zhan Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me rregullat 80(1) dhe 113(1)-(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala ("z. Shala") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjika").⁵
3. Më 15 prill 2021, pas përmbylljes së procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës Kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u lëshuan më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 maj 2021, F00008/RED. F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 prill 2021, F00019/RED.

4. Më 1 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat” (“Vendimi Kornizë”).⁷
5. Më 1 tetor 2021, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (“ZPV”) parashtrori “Raportin e Parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces” (“Raporti”).⁸ ZPV-ja parashtron, midis tjerash, se raporti është protokolluar si konfidencial dhe *ex parte*, por nuk e kundërshton riklasifikimin e Raportit si publik meqenëse nuk përmban informacion që identifikon parashtruesin e kërkesës.⁹ ZPV-ja shton se shtojca përmban informacion identifikues dhe rrjedhimisht është protokolluar si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.¹⁰

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me rregullën 80(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të urdhërojë *proprio motu* masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmimeve të dëshmitarëve, me kusht që masat të jenë në pajtim me të drejtat e të Akuzuarve.
7. Në përputhje me rregullën 113(1)-(3) të Rregullores, palët nuk kanë qasje në formularët e kërkesave për pjesëmarrje të viktimave dhe marrin vetëm raportin konfidencial të ZPV-së, në bazë të të cilit mund të bëjnë parashtrime në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00064, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 1 shtator 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00085, Administratorja, *Raporti i Parë i Zyrës Administrative Drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 1 tetor 2021, konfidencial dhe *ex parte*, së bashku me një shtojcë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ Raporti, para. 7.

¹⁰ Raporti, para. 8.

III. DISKUTIM

8. Pasi ka shqyrtuar Raportin dhe shtojcën e tij, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se, në rrethanat e procesit aktual, Raporti mund t'u jepet palëve pa redaktime. Shtojca do të mbetet e klasifikuar si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Sidoqoftë, duke pasur parasysh përshkrimin e krimeve të pretenduara dhe të dëmit të pësuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe duke vënë në dukje se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që informacioni identifikues të mos i nxirret publikut,¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien dhe privatësinë e parashtruesit të kërkesës, Raporti nuk duhet t'i nxirret publikut në formën që ka aktualisht.

9. Në përputhje me sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Administratoren të riklasifikojë Raportin si konfidencial. Gjithashtu, ZPV-ja duhet të redaktojë në Raport të gjithë informacionin identifikues që del nga përshkrimi i krimeve të pretenduara dhe i dëmit të pësuar dhe të parashtrojë një version të redaktuar publik të tij.

10. Në fund, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me Vendimin Kornizë, Palët duhet t'i protokollojnë parashtrimet e tyre ligjore për rekomandimet e ZPV-së në lidhje me pranueshmërinë, përfaqësimin e përbashkët dhe masat mbrojtëse, brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për Raportin.¹²

¹¹ Raporti, para. 18-27, 34.

¹² Vendimi Kornizë, para. 58-60, 63(g).

